

**MEMORANDUM MIRËKUPRIMI MBI BASHKËPUNIMIN
MIDIS**

**ZYRËS SË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE**

ZYRËS SË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

**NË LUFTËN KUNDËR KRIMIT NDËR-SHTETËROR, TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE
DHE EMIGRIMIT TË PALIGJSHËM**

Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm të Shqipërisë dhe Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Maqedonisë, përcaktuar më tej si "Palët",

- duke synuar vendosjen e bashkëpunimit dypalësh në luftë kundër krimit ndër-shtetëror, trafikimit të qenieve njerëzore dhe emigracionit të paligjshëm;
- të udhëhequr nga parimet e barazisë, mirëkuptimit dhe interesave të ndërsjellë, përmbushjes së detyrimeve në mirëbesim dhe në respektim të të drejtave të njeriut;
- duke zbatuar parimet e përcaktuara në Konventën Evropiane për "Ndihmë të Ndërsjellë në Cështjet Penale" e vitit 1959, dhe në Marrëveshjet e tjera dypalëshe dhe shumëpalëshe,

KANË RËNË DAKORD SI MË POSHTË:

1. Palët, brenda kuadrit të kompetencave të tyre dhe në përputhje me legjislacionin e brendshëm të vendeve përkatëse, do të bashkëpunojnë në luftën kundër krimit ndër-shtetëror, trafikimit të qenieve njerëzore dhe emigracionit të paligjshëm.
2. Bashkëpunimi, në kuadër të këtij Memorandumi, do të realizohet nga Palët nëpërmjet shkëmbimit të informacioneve dhe dokumentave, në lidhje me krimet me karakter ndër-shtetëror dhe personave të përfshirë në to. Në këtë rast Palët, duke respektuar kërkesat e konfidencialitetit, do të shkëmbejnë informacion mbi shtetasit e vendeve të tyre, shtetasit e huaj si dhe personat pa shtetësi, të cilët janë në gjykim, për shkak të aktivitetit të tyre të ndëshkueshëm lidhur me krimin ndër-shtetëror, trafikimin e qenieve njerëzore dhe emigracionin e paligjshëm.
3. Palët do të ndërmarrin çdo masë të nevojshme, brenda kufijve të kompetencave të tyre, me qëllim që të ndihmojnë në ekzekutimin sa më të efektshëm dhe në kohë, të kërkesave për ndihmë ligjore në cështjet penale, lidhur me krimet ndër-shtetërore, trafikimin e qenieve njerëzore dhe emigracionin e paligjshëm, nëse këto kërkesa janë pranuar nga autoritetet kompetente të Shtetit të kërkuar.

4. Palët do të krijojnë marrëdhënie profesionale ndërmjet përfaqësuesve të tyre, me qëllim përditësimin e efektshëm të përvojave të tyre, shkëmbimin e informacionit dhe të të dhënave mbi legjislacionin aktual, në mënyrë të vecantë shkëmbimin e dispozitave ligjore dhe akteve e tjera rregulluese duke përfshirë materiale të karakterit analitik, statistikor apo informues mbi goditjen e krimit ndër-shtetëror, trafikimin e qenieve njerëzore dhe emigracionin e paligjshëm.

5. Me qëllim zbatimin e këtij Memorandumi, Palët do të kontaktojnë drejtpërdrejt me njëra tjetrën, pa përjashtuar mundësinë e përdorimit të kanaleve diplomatike.

Për të kontaktuar drejtpërdrejt, palët do të përdorin adresat dhe mjetet e mëposhtme të komunikimit:

PALA SHQIPTARE :

Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm
Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë
Rruga "Qemal Stafa" Nr. 1 Tiranë,
Albania
Tel/Fax: 00355 4 235323
E-mail: foreigndepart@pp.gov.al

PALA MAQEDONASE :

Javno Obvinitelstvo na Republika Makedonija
Oddelenie za borba protiv storitelite na dela od
oblasta na organiziraniot kriminal i korupcijata
Blv. Krste Misirkov bb, Sudska Palata,
1000 Skopje, Republika Makedonija
Telefoni: +389 3/219- 850
Faksi: +389 3/219-866
E-mail: jorm@jorm.org.mk

6. Bashkëpunimi brenda kuadrit të këtij Memorandumi do të realizohet mbi bazën e kërkesave për informacion. Çdonjëra prej palëve, mund t'i dërgojë tjetrës informacion edhe pa kërkesë paraprake, kur ajo gjykon që informacioni i tillë mund të ndihmojë atë për të filluar ose kryer hetime.

7. Kërkesat për informacion dhe përgjigjet përkatëse do të dërgohen drejtpërdrejt, me shkrim dhe në gjuhën e palës kërkuese së bashku me përkthim në gjuhën e palës së kërkuar ose në gjuhën angleze. Në raste urgjente, kërkesa të tilla mund të dërgohen me postë elektronike, me faks ose me mjete të tjera teknike të komunikimit.

8. Kërkesat për informacion do të ekzekutohen nga secila palë, në përputhje me legjislacionin e vendit përkatës. Në rastet kur ekzekutimi i kërkesës është i pamundur, pala e kërkuar do të informojë menjëherë palën kërkuuese për arsyet të cilat penguan ekzekutimin.

9. Pala, e cila dërgon informacione ose dokumenta në përputhje me dispozitat e këtij Memorandumi, mund t'i kërkojë palës tjetër ruajtjen e konfidencialitetit dhe përdorimin përkatës. Nëse pala kërkuuese ka nevojë të përdorë informacionin dhe materialet për nevojat e procesit gjyqësor, duhet të paraqesë kërkesë për ndihmë juridike në përputhje me rregullat e përcaktuara nga ligji ndërkombëtar dhe legjislacioni i brendshëm i vendit përkatës.

10. Gjithë çështjet e lidhura me interpretimin dhe zbatimin e këtij Memorandumi do të zgjidhen nga Palët në bazë të parimeve të mirëkuptimit dhe respektit të ndërsjellë. Në çdo kohë, ky Memorandum mund të plotësohet dhe ndryshohet me marrëveshje të përbashkët mes palëve.

11. Ky memorandum nuk krijon ndonjë detyrim ndër-shtetëror të ri për Palët dhe Shtetet e tyre dhe nuk prek asnjë prej detyrimeve ndërkombëtare që ato kanë. Bashkëpunimi në kuadër të këtij memorandumi do të realizohet mbi bazën e vullnetit konstant të palëve për të arritur vendime praktike në fushën e luftës kundër krimit ndër-shtetëror, trafikimit të qenieve njerëzore dhe emigracionit të paligjshëm dhe në frymën e partneritetit që karakterizon këtë dokument.

12. Ky Memorandum do të hyjë në fuqi datën e firmosjes dhe do të përfundojë në një periudhë të pacaktuar. Çdonjëra palë mund të informojë tjetrën, me shkrim, mbi qëllimin e saj për të përfunduar marrëveshjen. Në këtë rast, Memorandumi e humbet fuqinë pas gjashtë muajsh nga data e njoftimit për përfundimin etij.

Nënshkruar në Ohër në 30 Maj 2007 në katër kopje, respektivisht në maqedonisht, serbisht, shqip dhe anglisht.


Në rast mosmarrëveshesh lidhur me interpretimin ose zbatimin e dispozitave të këtij Memorandumi, teksti anglisht do të paraprijë.

Prokurori i Përgjithshëm
i Republikës së Maqedonisë



Ljupco Svirgovski

Prokurori i Përgjithshëm i
Republikës së Shqipërisë



Theodhori Sollaku